



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 103, datë 23.05.2025

PËR
“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI PËR
PROKUROREN DOLOREZA MUSABELLIU”

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23.05.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokuroren Doreza Musabelliu”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1360 prot., datë 19.05.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi relatorin z. Erion Fejzulla, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,



V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, Këshilli shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.

2. Pranë Këshillit, është administruar me nr. 1384 prot., datë 19.05.2025, shkresa e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me nr. 16801 Prot./D.M., datë 14.05.2025, "Dërgojmë kërkesën e prokurorit", me të cilën është përcjellë një "Kërkesë për veprimtari jashtë funksionit" e prokurores Doloreza Musabelliu.

3. Referuar përmbajtjes së shkresës dhe dokumentacionit shoqërues, prokurorja Doloreza Musabelliu kërkon nga Këshilli miratimin e kërkesës për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit si *eksperte për trajnimin rajonal me fokus në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, "Forcimi i kapaciteteve për të identifikuar, mbledhur dhe përdorur provat në mënyrë efikente në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore", i organizuar nga UNDOC në Tiranë*. Trajnimi do të realizohet 2 orë, në datat 3 - 4 qershor 2025.

4. Sipas kërkesës së prokurores vlera e pagesës për kryerjen e këtij trajnimi nuk është përcaktuar ende. Kërkesa shoqërohet edhe nga Vërtetimi datë 14.05.2025, i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në të cilin Këshilli njoftohet se:

"Prokurorja Doloreza Musabelliu, aktualisht ushtron detyrën e prokurores, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.

Aktualisht kjo prokurore ka në hetim 40 (dyzet) çështje penale.

Prej saj, rezulton të jenë ushtruar në kohë detyrat, me korrektësi dhe efikence.

Ushtrimi i rolit të ekspertit, në kuadrin e aktivitetit që zhvillohet nga UNDOC, me një trajnim rajonal që do të organizojë UNDOC në Tiranë me fokus në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, "Forcimi i kapaciteteve për të identifikuar, mbledhur dhe përdorur provat në mënyrë efikente në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore"... vlerësohet se nuk përbën pengesë për ushtrimin e funksionit të saj si prokurore.

Lëshohet ky vërtetim me kërkesë të të interesuarit."

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se prokurorja Doloreza Musabelliu nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi, si dhe faktin se përgjatë veprimtarisë së Këshillit ka marrë dhe disa herë të tjera miratime për veprimtari jashtë funksionit të prokurorit.

6. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar vlerësohet nga Këshilli se nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së saj, si dhe:

- është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohet sipas ligjit;

- 
- nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
 - nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.

7. Këshilli vlerëson se, kërkesa e prokurores Doloreza Musabelliu për të ushtruar veprimtari jashtë funksioni sipas objektit të saj përmbush kriteret ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës, nenin 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 157, 164, dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Doloreza Musabelliu si eksperte për trajnimin rajonal me fokus në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, *“Forcimi i kapaciteteve për të identifikuar, mbledhur dhe përdorur provat në mënyrë efikase në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore”*, i organizuar nga UNDOC në Tiranë, në datat 3 - 4 Qershor 2025.
2. Ky vendim i njoftohet prokurores Doloreza Musabelliu dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.05.2025.

KRYETAR

Mirela Bogdani

